



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

V E N D I M

Nr. 69 Datë 24.12. 2007

PËR

**MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS SË AUTORITETIT TË
KONKURRENCËS.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | |
|---------------------------|------------|
| ▪ Znj. Lindita MILO(LATI) | Kryetar |
| ▪ Z. Lush PËRPALI | Zv/Kryetar |
| ▪ Znj. Servete GRUDA | Anëtar |
| ▪ Z. Koço BROKA | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 24.12.2007, në mbështetje të nenit 24 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe duke marrë parasysh Ligjin Nr. 8549 ,datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, Ligjin Nr 9131 ,datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës Administratën Publike”, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “ Për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, Ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Ligjin nr 8484, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe eksperiencën e Autoriteteve të Konkurrencës së vendeve anëtare të BE-së:

VENDOSI:

1. Miratimin e “Kodi i Etikës së Autoritetit të Konkurrencës”, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Shefi i Kabinetit dhe Sekretari i Përgjithshëm për të marrë masat e nevojshme për përfshirjen në aktet e emërimit dhe në kontratën e punës të klauzolave për njohjen dhe zbatimin e këtij Kodi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush PËRPALI

(_____)
Zv/Kryetar

Servete GRUDA

(_____)
Anëtar

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R